



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



www.komuna-klina.org

*Komuna e Klinae*

*Zyra e Prokurimit*

01 Nr. 344-5971/8

Me 10, 09, 2018

## **KONTRATA PUBLIKE KORNIZË**

### **KUSHTET & ANEKSET E NDËLIDHURA**

**PJESA I E KONTRATËS: KONTRATA PUBLIKE KORNIZË nr.067/2018**

**KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në një të anë; qe përfaqësohet nga Menaxheri i prokurimit z.Abaz Foniqi

dhe

**RADIO ALBA** "adresa **KLINA** (në vazhdim "Ofruesi i Shërbimeve"), me nr. Bisnesi 80331517 dhe numer fiskal 600189410 në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për Shërbimet në vijim:

### **TRANSMETIME TE SEANCAVE TE KUVENDIT DHE AKTIVITETEVE TJERA TE KOMUNES**

me numër identifikues: 634-18-5483-2-2-1/634-18-073-221

#### **Neni 1 Lënda**

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim

1.2. Transmetim drejtepersedrejt i seancave te Kuvendit dhe aktiviteteteve tjera te komunes , me kerkese te Personit pergjegjes

**1.3.Vlera e Planifikuar e kontrates eshte 10.000.00€ ( Dhjetemijeuro ).**

1.4 Kontrata publike kornizë do të implementohet me “vendosjen e porosive” apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë “porosinë” tek Ofruesi i shërbimeve, duke specifikuar listën e shërbimeve qe duhet te performohen me sasi të tyre përkatëse.

1.5 Sasi të e vlerësuar, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative. Autoriteti(et) Kontraktues i përmendur në Nenin1.1 është (janë) i/të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokurojnë shërbimet e përmendura në 1.1.Sasia indikativë gjate ekzekutimit mund te jene ( + ) ( - ) 30 % nga njesite e Planifikuara .

1.6 Kontrata hynë në fuqi me 11.09.2018 dhe përfundon në datën 10.09.2021

**Neni 2 Koha e përfundimit**

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë menjëherë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes ( kërkesës ) nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë Kline

**Neni 3 Çmimi**

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Nr.	Pershkrimi i shërbimeve	njesia	Sasia	Cmimi	Vlera
1	Transmetimi i seancave te rregullta	Seanca	33	250.00	8.250.00
2	Transmetimi i seancave Solemne	Seanca	6	50.00	300.00
3	Transmetimi i debateve	Seanca	6	100.00	600.00

	me publikun				
4	Transmetimi i seancave te Veqanta	Seanca	3	150.00	450.00
5	Transmetim te reklamave dhe njoftimeve	minuta	50	2.00	100.00
6	Transmetim prezantimeve i te aktiviteteve	minuta	100.00	3.00	300.00

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësisve do të jenë fikse dhe nuk do të nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

- Pas cdo kryerje të shërbimit me Fature dhe Raport nga Organi përgjegjës për Monitorim ,Zyrtari përgjegje për Shërbime të Kuvendit . Jo me gjate se 30 dite nga Pranimit i Fatures .

#### **Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës**

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofruesit të Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

#### **Neni 5 Komunikimet**

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofruesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.


5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në


komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.


5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhët Shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Ofruesin e Shërbimeve.


**Për Autoritetin Kontraktues Komuna Kline**

<b>Emri:</b>	Abaz Foniqi
<b>Pozita:</b>	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	10.09.2012
<b>Vula:</b>	



**Për Ofruesin e Shërbimeve RADIO ALBA- KLINE**

<b>Emri:</b>	ILIR MUSOLLU
<b>Pozita:</b>	menaxher
<b>Nënshkrimi:</b>	
<b>Data:</b>	10.09.2012
<b>Vula:</b>	



## PJESA V E KONTRATËS: IDENTIFIKIMI FINANCIAR

MBAJTËSI I LLOGARISË	
<b>Name</b>	
<b>Emri</b>	
<b>Adresa</b>	
<b>Qyteti</b>	
<b>Kodi Postar</b>	
<b>Kontakti</b>	
<b>Telefoni</b>	
<b>Faksi</b>	
<b>E-mail</b>	
<b>Numri i TVSH</b>	

BANKA	
<b>Name</b>	
<b>Emri</b>	
<b>Adresa</b>	
<b>Qyteti</b>	
<b>Kodi Postar</b>	
<b>Shteti</b>	
<b>Llogaria Bankare</b>	
<b>IBAN (opcionale)</b>	
<b>BIC (Opcionale)</b>	

### SHËNIME:

<b>VULA E BANKËS + NËNSHKRIMI I PËRFAOËSUESIT TË BANKËS (Të dyja të obligueshme)</b>
--

<b>DATA + NËNSHKRIMI I MBAJTËSIT TË LLOGARISË: (e obligueshme)</b>
--

VNT

## **PJESA IV E KONTRATËS: MODEL I SIGURISË SË EKZEKUTIMIT**

*[Llogon e institucionit financiar i cili siguron garancionin]*

**Për: KUVENDI KOMUNAL I KLINËS**

(në vazhdim "Autoriteti Kontraktues").

**Në emër të: RADIO ALBA - KLINE**

(në vazhdim "operatori ekonomik")

**Titulli i aktivitetit të prokurimit: TRANSMETIMI I SEANCAVE TE KUVENDIT DHE AKTIVITETEVE TJERA TE KOMUNES**

**Numri i prokurimit: 634-18-5483-2-2-1/634-18-073-221**

### **Garancion me kërkesë të parë**

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të ekzekutimit duke iu referuar Dosjes së Tenderit , me numër të prokurimit të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurinë në shumën e saktësuar në Dosjen e tenderit;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë siguri:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total prej: **10 % vleres se Kontrates 1.000.00 euro** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- a) Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë; dhe
- b) Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar prej: **10.000.00 €** siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

**Kjo siguri vlen deri me: 10.10.2021**

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesve

Emri i institucionit financiar

Adresa

Data